

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-254/13

**Prishtinë,
12 Gusht 2015**

Në çështjen juridike të:

B. V.

Serbi

Pala ankuese

Kundër

K. K.

M. M.

K. S.

I. G.

L. M.

R. M.

R.S.

R. S.

N. M.

H.N.

B. P.**B. G.****M. K.****I. P.****Xh.G.****B. M.****B. K.****S.M.*****Palët përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA22867, KPA22873 dhe KPA22874) të datës 14 dhjetor 2012 dhe vendimit KPCC/D/R/183/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA22868) të datës 14 dhjetor 2012, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 12 Gusht 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga **B. V.**, të regjistruara me numrat **GSK-KPA-A-254/2013**, **GSK-KPA-A-255/2013**, **GSK-KPA-A-259/13** dhe **GSK-KPA-A-260/13**, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin **GSK-KPA-A-254/2013**.
2. Hedhen poshtë si të pasafatshme ankesat e paraqitura nga **B. V.** ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPCC/D/A/180/2012** (lëndët e regjistruara në AKP me numrat **KPA22867**, **KPA22873** dhe **KPA22874**) të datës 14 dhjetor 2012 dhe vendimit **KPCC/D/R/183/2012** (lënda e regjistruar në AKP me numrin **KPA22868**) të datës 14 dhjetor 2012.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 prill 2007, B. V., (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur katër kërkesa individuale në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon të drejtën e ri-posedimit dhe kompensim për shkaktimin e dëmit ose për humbjen e shfrytëzimit të pronave të kërkuara.
2. Në këto kërkesa ai kishte theksuar se pronat e kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, ku përmendet data 17 qershor 1999 si data e humbjes.
3. Për të mbështetur kërkesat e tij ai kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Fletën poseduese nr. 772 të lëshuar nga Organi Paralel Qendra për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Klinës, e datës 3 prill 2002, që tregon se pronat e kërkuara ishin në posedim të B. V.
 - Autorizimin e datës 18 maj 2012 që tregon se B. V. e kishte autorizuar R. D. për të vepruar në emër të tij para AKP-së.
 - Dokumente tjera (Kontrata të Blerjes) të cilat nuk kanë të bëjnë me pronat e kërkuara.
4. Sipas Fletës Poseduese nr.772 të Organit Paralel Qendra për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Klinës, të datës 3 prill 2002, ngastrat kadastrale të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës, që ndodhen në zonën kadastrale të Komunës së Klinës, janë të regjistruara në emrin e tij si më poshtë:

Numri i ankesës dhe numri i lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-254/13 (KPA22867)	Ngastra nr.433/1, në vendin e quajtur "Sello", vresht a klasit të dytë me sipërfaqe prej 00.19.52 ha
GSK-KPA-A- 255/13 (KPA22868)	Ngastra nr. 433/1, në vendin e quajtur "Sello", shtëpi dhe oborr me sipërfaqe prej 0.05.46 ha
GSK-KPA-A-259/13 (KPA22873)	Ngastra nr. 586/2, në vendin e quajtur "Vakaf", livadh i klasit të pestë me sipërfaqe prej 00.34.52 ha

GSK-KPA-A-260/13 (KPA22874)	Ngastra nr. 586/3, në vendin e quajtur “Vakaŕ”, livadh i klasit të tretë, me sipërfaqe prej 0.44.86 ha
------------------------------------	--

5. Identifikimi fizik i kërkesave (KPA22767 dhe KPA22868) ishte kryer më 8 maj 2012 dhe pronat e kërkuara janë klasifikuar si rrugë publike që shfrytëzohet nga persona të panjohur, ndërsa identifikimi i pronave për kërkesat (KPA22873 dhe KPA22874), ishte kryer më 26 qershor 2012 dhe pronat e kërkuara figurojnë të jenë të ndara në numra të rinj të ngastrave, secila ngastër e uzurpuar nga një palë e ndryshme përgjegjëse në kërkesë të cilët kishin ndërtuar objekte.
6. Palët përgjegjëse në kërkesë (M. M., K. S., I. G., L. M., R.M., R. S., R. S., N. M., H. N., B. P., B. G., M. K., I. P., Xh. G., B. M., B. K.) kanë kërkuar të drejtat ligjore mbi pronat e kërkuara.
7. Për të mbështetur kërkesat e tyre ata kishin dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Autorizimin V.nr. 1120-V-002, të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Novi Sadit më 29 maj 2002. Paraqitësi i kërkesës, kishte autorizuar B. Š. për të gjetur një blerës, për të negociuar çmimin e blerjes, për të shitur dhe bartur të drejtën e pronës në emër të blerësit lidhur me ngastrat me numrin 586/2 dhe 586/3.
 - Deklaratën V.nr. 1121-V/002, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Novi Sadit më 29 maj 2002 që tregon se paraqitësi i kërkesës si dhe fëmijët e tij (P. V. dhe B. V.) kanë pohuar se i kishin shitur pronën e kërkuar N. M. përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar B. Š. dhe se ata kanë pranuar shumën prej 100.000 Euro në emër të transaksionit të blerjes.
 - Autorizimin V.nr. 1360/2002, të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Rozhajës më 3 qershor 2002, me të cilën B. Š. ka autorizuar N. H. për të nënshkruar kontratën e blerjes në emër të paraqitësit të kërkesës si dhe për ta certifikuar kontratën në gjykatën kompetente. Subjektet e kontratës së blerjes ishin pronat e kërkuara.
 - Kontratën e Blerjes Vr.Nr.873/2002 të certifikuar në Gjykatën Komunale të Klinës më 4 qershor 2002. Kontrata ishte lidhur në mes të B. V. si shitësi (i përfaqësuar nga B. Š. i cili kishte autorizuar N. H. të përfaqësonte B. V.) dhe N. M. si blerës i pronave të kërkuara.
 - Deklaratën Ov.Br.1361/2002 të vërtetuar në Gjykatën Themelore të Rozhajës më 3 qershor 2002, përmes së cilës B. Š. kishte pohuar se ai ia kishte shitur pronat e kërkuara N. M.
 - Dokumentet e tjera që tregojnë se N. M. ia kishte shitur pronat e kërkuara palëve të treta/palëve përgjegjëse në kërkesë. Secila palë përgjegjëse në kërkesë kishte dorëzuar Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme ku paraqitet numri i ngastrës që ata e kishin blerë nga N.M.
8. Sipas raportit të verifikimit të datës 28 shkurt 2008; pronat e kërkuara ishin gjetur në emër të K. K. (KPA22767 dhe KPA22868) ndërsa raporti i verifikimit i datës 20 qershor 2012 (KPA22767 dhe

- KPA22868) paraqet pronat e kërkuara në emër të N. M. dhe palëve të treta. Ndryshimet janë bërë bazuar në Kontratën e Blerjes Vr.Nr.873/2002 të datës 4 qershor 2002.
9. Përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës e ka mohuar se paraqitësi i kërkesës kishte shitur pronat e kërkuara dhe kishte theksuar se të gjitha dokumentet ishin falsifikuar nga personat që kanë pretenduar se i kanë blerë pronat.
 10. Më 14 dhjetor 2014 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës i kishte hedhur poshtë kërkesat me vendimet e vërtetuara KPCC/D/A/180/2012 dhe KPCC/D/R/183/2012. Në paragrafin 23 të vendimit, KPCC/D/A/180/2012 i cili zbatohet posaçërisht ndaj kërkesave nr. KPA22867, KPA22873, KPA22874 dhe në paragrafin 17 të vendimit KPCC/D/R/183/2012 i cili zbatohet posaçërisht ndaj kërkesës KPA22868, theksohet se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin mbi pronën e kërkuar si rezultat i konfliktit të viteve 98-99 por si rezultat transaksionit vullnetar të shitjes pas konfliktit, rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit.
 11. Më 5 gusht 2013 vendimi i është dorëzuar B. V. Ai (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) kishte paraqitur ankesë ndaj vendimit më 5 shtator 2013. Gjykata Supreme i kishte pranuar lëndët më 21 dhe 26 nëntor 2013.
 12. K. K.e kishte pranuar vendimin më 26 prill 2013 në cilësinë e palës përgjegjëse në ankesë (KPA22867, KPA22868). Vendimi i ishte dorëzuar të gjitha palëve përgjegjëse në kërkesë personalisht më 14 maj 2013, 16 maj 2013 dhe 24 maj 2013 (KPA22873 dhe KPA22874).

Pretendimet e palës ankuese

13. Pala ankuese thekson se vendimet e KKKP- së janë mbështetur mbi shkeljen e së drejtës materiale dhe procedurale dhe gjithashtu mbi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
14. Pala ankuese thekson se arsyeja për refuzimin e kërkesës së tij nuk ishte dhënë në asnjë pjesë të arsyetimit ligjor të vendimeve të KKKP-së.
15. Sipas palës ankese, bazuar në vendime të tilla për të cilat nuk është dhënë asnjë arsyetim, ai mundet vetëm të supozoj se arsyeja e vetme ligjore për refuzimin e kërkesës së tij mund të jetë se dikush në mënyrë joligjore ka tjetërsuar pronat dhe se ai nuk ka qenë në dijeni për këtë.
16. Pala ankuese ka theksuar se ai asnjëherë nuk i kishte tjetërsuar pronat e tij dhe as nuk kishte autorizuar askënd asnjëherë për të shitur pronat e tij.
17. Gjithashtu, pala ankuese ka shtuar se më 17 gusht 2010, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar ka kërkuar nga Gjykata Komunale e Klinës që t'i siguroj një kopje të provave në bazë të së cilave kontrata e blerjes (që tregon se K.K. ka blerë pronat e kërkuara nga ai) ishte certifikuar. Gjykata Themelore e Pejës, dega në Klinë, deri më sot nuk i është përgjigjur atij dhe kjo shpie në faktin se pala ankuese nuk i ka shitur pronat e kërkuara.

18. Në fund të ankesës pala ankuese thekson se Komisioni ka qenë i obliguar t'i dorëzoj atij kontratat e blerjes me anë të së cilave gjoja janë shitur pronat e kërkuara nëse kontratat e tilla ekzistojnë si dhe t'i pasqyrojnë këto kontrata në arsyetimin e vendimit të saj, kështu, ai do të shfrytëzonte të gjitha mundësitë për të kundërshtuar shitjen dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme ligjore për të dëshmuar se kontrata e blerjes faktikisht ishte falsifikuar.
19. Pala ankuese gjithashtu kishte prezantuar:
- Kërkesën drejtuar Gjykatës Komonale në Klinë, me të cilën pala ankuese kërkon të marrë Kontratën e Blerjes e cila gjoja pasqyron se ai ka shitur ngastrën nr. 433/1 të Fletës Poseduese nr. 772.
20. Palët përgjegjëse në ankesë nuk janë përgjigjur në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Bashkimi i ankesave

21. Sipas nenit 13.4 të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendos për bashkimin apo shkrirjen e ankesave kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a) të Ligjit. Ky nen i mundëson Komisionit të marr parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave për të shqyrtuar lëndën dhe marrë vendime kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
22. Dispozitat e Ligjit për Procedurën Civile që aplikohen në procedurat para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079, si dhe me dispozitën e nenit 408.1 e lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, ofrojnë mundësinë e bashkimit të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të sigurojë efektivitetin e gjykatës dhe efikasitetin e lëndës.
23. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme thekson se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilin është paraqitur ankesa përkatëse, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë krejtësisht të njëjta në të dy lëndët. Vetëm kultura e ngastrave dhe numrat e ngastrave që janë subjekt i së drejtës pronësore e cila pretendohet në secilën kërkesë, është e ndryshme. Ankesat mbështeten në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.
24. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-254/13 deri GSK-KPA-A-255/13, GSK-KPA-A-259/13 dhe GSK-KPA-A-260/13 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-254/13.

Pranueshmëria e ankesës

25. Ankesa është e pasafatshme.
26. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh me sa vijon: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës lidhur me vendimin e Komisionit për kërkesën, pala mund të paraqes ankesë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të tillë”*.
27. Palës ankuese i është dorëzuar vendimi ditën e Hënë , më 5 gusht 2013. Afati kohor fillon nga dita e Martë , më 6 gusht 2013. Prandaj, afati kohor ka përfunduar më 4 shtator 2013. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesën e tij ditën e Enjte, më 5 shtator 2013. Kjo është jashtë afatit kohor.
28. Prandaj, ankesa është dashur të hedhet poshtë si e papranueshme për shkak të arsyeve procedurale (neni 13.3 nën-paragrafi (b) i rregullores së UNMIKUT 2006/50 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) po ashtu në bazë të nenit 195.1 (a) dhe nenit 196 të LPK-së.

Këshillë ligjore

29. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Elka Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it